



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

RELACION TEKNIK

Mirembajtje me performance rruga: **“Kthesa e Lapidarit- Rreshen” (25.8 km).**

Përshkrim i përgjithshëm.

Aksi rrugor **“Ura e Matit- Rreshen” (30.1 km)**, perbehet nga dy nensegmente : **“Ura e Matit – Kthesa e Lapidarit” 4.3 km** pjesë e inventarit të DRV Shkodër dhe **“Kthesa e Lapidarit – Rrëshen” 25.8 km** i cili është një segment rrugor në inventarin e Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Rrëshenit me qytetet tjera dhe më gjerë si: Burrel, Klos, Bulqizë, Peshkopi, Maqedonia e Veriut etj. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore, me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6.5 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij, si segment me mirëmbajtje dimërore.

Përshkrimi i situatës aktuale të segmentit.

Aksi rrugor fillon nga dalja e qytetit të Rrëshenit (Ura e Rrëshenit) dhe mbaron në degëzim në aksin nr 6, Burrel – Peshkopi pranë urës së Matit me gjatësi prej 30.1 km. Rruga ka gjerësi karrexhate 6.5 ml të asfaltuar. Gjendja e rrugës nuk është e mirë pasi ky segment rrugor është rikonstruktuar në vitin 2013 me financim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, por cilësia e dobët e punimeve, përdorimi i rrugës nga mjetet me tonazh të rëndë, që transportojnë mineralin e kromit për në portin e Durrësit e gjetkë, si dhe mungesa e mirëmbajtjes për një periudhë të gjatë kanë qenë faktorët për amortizimin e shpejtë të kësaj rruge. Rruga duhej t’i kalonte Këshillit të Qarkut Dibër, në vitin 2015 dhe ky i fundit tja dorëzonte pushtetit vendor. Por për shkak të gjendjes së degraduar, Bashkia Mat në atë kohë nuk pranoi ta inventarizonte. Duke u nisur nga fakti se aksi rrugor **“Ura e Matit- Rrëshen” (30.1 km)**, që nga përfundimi i punimeve të sistemim – asfaltimit në vitin 2013, nuk u mirëmbajt e asnjëherë dhe ky aks rrugor degradoi nga mungesa e mirembajtjes dhe cilësisë së dobët të punimeve. Vitin e fundit e në vazhdim me kontrate mirëmbajtje u përfshi segmenti **4.3 km** nga **“Ura e Matit deri te kthesa e Lapidarit”**. Ky aks rrugor ka dëmtim të nënshtresave dhe shtresave asfaltike në vende të ndryshme, dëmtim të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

sinjalistikës vertikale si dhe atë horizontale (nuk ka asnjë gjurmë), dëmtim të trupit të rrugës në hyrje të urave, dëmtim të barrierave mbrojtëse, shembje të skarpateve etj.

Aktualisht *Ky aks kërkon rehabilitim total.*

Të ndodhur në kushtet kur sapo është përfshirë në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar me VKM 234, datë 17.04.2024, deri në momentin kur do të ndërhyhet për një rehabilitim të plotë të këtij segmenti, është e domosdoshme përfshirja e tij në kontrata mirëmbajtjeje me qëllim sigurimin e kushteve për kalimin e mjeteve nëpërmjet realizimit të disa punimeve që lidhen me mbushje me çakull të gropave dhe plotësim me sinjalistikë vertikale.

Nga Specifikimet teknike, për këtë segment, do të jetë merret në konsideratë vetëm pjesa ku citohen segmente rrugore të pashtruar, si dhe për zërat e punimeve të rutinës, të listuara si më poshtë:

A MIRËMBAJTJE RUTINË

Zëri 1: “Pastrimi i kanaleve dhe kunetave”

Zëri 2: “Pastrimi i tominove ekzistuese rrethore dhe katrore”

Zëri 4: “Pastrimi i vegjetacionit”

Zëri 5: “Pastrimi i karrexhatës nga aluvionet”

Zëri 7: “Mbushje dhe profilim në rrugët e pashtruara”

Zëri 10: “Mirëmbajtje rutinë e skarpatave dhe veprave të artit”

B “Mirëmbajtje dimërore”.

